

UDHËZIM
Nr. 6, datë 24.4.2024

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015, “PËR PËRMBAJTJEN
DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË
PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË
MËSUESIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “d”, të pikës 8, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të udhëzimit nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, të ndryshuar, pas profilit me numër rendor 26, të shtohet profili me numër rendor 27 si më poshtë:

“27. Ekonomi, kodi 27”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu